



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 144 Akti

Nr. 106 Vendimi
Tiranë, më 13.02.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Firdes Shuli	Anëtare
Pamela Qirko	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatini, më datë 12 shkurt 2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i parë, salla ovale, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Ana Gollosi**, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht dhe pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. **Komisioni i Pavarur i Kualifikimit**, është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në nenin 3, pika 5 dhe nenit 5, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. **Subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, me funksionin ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë**, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “**Komisioni**”), ka hedhur shortin, më datë 15.05.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Firdes Shuli dhe Pamela Qirko. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 25.05.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Etleda Çiftja, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Ana Gollosi.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt

të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, u administrua shkresa me nr. *** prot., datë 08.02.2018, e **Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)**, me anë të së cilës dërgohet një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Golloshi. Rezulton se, znj. Ana Golloshi, është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së bazuar në nenin 31 të ligjit nr. 84/2016 dhe se për nga funksioni që ka pasur nuk ka qenë përfshirë në kategorinë e subjekteve që mbartnin detyrim për deklarimin e pasurisë pranë ILDKPKI-së. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. **Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka

dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2017, (deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së, nr. ***, datë 18.02.2018) në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar, *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Golloshi.*

12. **Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD)** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi tre kriteret, atë të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, më datë 22.01.2019, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, znj. Ana Golloshi; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, më datë 22.01.2019, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes më datë 28.01.2019 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 09.02.2019.

16. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, më datë 06.02.2019.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Ana Golloshi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, më datë 12.02.2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i parë, salla ovale, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

19. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, nuk ka treguar gatishmëri gjatë procesit të rivlerësimit, në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016, duke dërguar deklaratimet e saj dhe provat përkatëse jashtë afateve të përcaktuara, gjë që ka çuar në vonesën e procesit të rivlerësimit.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.3. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21.4. Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21.5. Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017^[1] dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” të dorëzuar nga ana e subjektit pranë ILDKPKI-së; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (dh) raportin e analizimit të aftësisë profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLD; (e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

Dokumentacioni i analizuar përbëhet nga:

- Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së;
- Provat e tjera të administruara në dosjen e ILDKPKI-së;
- Provat e depozituara nga subjekti pranë Komisionit;
- Informacionet dhe të dhënat e administruara nga ky Komision nëpërmjet organeve shtetërore, personave fizikë dhe juridikë;
- Shpjegimet dhe deklaratat e subjektit në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni, të rezultateve të hetimit administrativ dhe shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore.

23.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar, “Vetting”, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi.

^[1] “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr.84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

23.2. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

24. Në deklaratën “Vetting” të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 27.01.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

24.1 Apartament¹, me sipërfaqe të brendshme 142 m², të ndodhur në, Rr: “**”, ndërtesa ****, hyrja ***, apartamenti ***, Njësia Bashkiake Nr. ****, Tiranë.**

- i. Vlera e deklaruar: 62.400 euro;
- ii. Pjesa në përqindje: 50 %, në bashkëpronësi me ½ me bashkëshortin;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhurat nga emigracioni.

Mënyra e fitimit të pasurisë: (1) kontratë sipërmarrje e datës 11.11.2003; (2) kontratë shitje me nr. ***kol, datë 16.11.2016.

- Subjekti deklaron se, kjo pasuri është regjistruar pranë ZVRPP-së ***, ZK ***, me nr. pasurie ***.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e apartamentit, me sipërfaqe 142 m², ndodhur në Rr: “****”, në vlerën totale prej 62,400 eurosh.

Hetimi i kryer nga Komisioni

ZVRPP-ja Tiranë ***, me shkresën nr. *** prot., datë 28.09.2018, na informon se nga verifikimi i bërë informacionit digjital dhe manual, si dhe dokumentacionit që disponon kjo zyrë, rezulton se në emër të znj. Ana Golloshit dhe z. Gj.S. (bashkëpronarë), janë të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasuritë me të dhënat si më poshtë:

- i. pasuria me nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, apartament, me sipërfaqe 79 m² (pasuri aktive);
- ii. pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, apartament, me sipërfaqe 142 m² (pasuri aktive);
- iii. pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, apartament, me sipërfaqe 63 m² (pasuri aktive).

¹ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks **** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) Certifikatë pronësie nga ZRVPP-ja Tiranë, datë lëshimi 19.1.2017; (2) kontratë shitje nr. ****, datë 16.11.2016; (3) kontratë sipërmarrje me nr. ***, datë 11.11.2003; (4) shtesë kontratë sipërmarrje me nr. ***, datë 11.12.2003; (4) deklaratë noteriale me nr. ****, datë 07.01.2004; (5) deklaratë noteriale me nr. ****, datë 04.05.2007.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së si edhe dokumentacionit të dërguar pranë Komisionit me shkresë nga ZVRPP-ja Tiranë lidhur me këtë pasuri, konstatohet se:

Më datë 11.11.2003, shtetasi Gj.S, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e porositësit ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “****”² sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, sipas së cilës sipërmarrësi merr përsipër ti ndërtoj porositësit apartamentet nr. *** dhe nr. **, në katin e *** të banimit (përjashtuar një kat dyqan), me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimore 156 m², të përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë e aksesorë dhe të bashkuar në një apartament. Nënshkrimi i kësaj kontrate nga palët, është legalizuar me vërtetim nënshkrimin, nr. **, redaktuar nga noteri Xh.H.

Referuar kësaj kontrate sipërmarrjeje, palët kanë rënë dakord që çmimi i përgjithshëm i shitjes të apartamenteve të mësipërm të jetë 62,400 euro, të cilat do paguhen me këste, si më poshtë:

- i. kësti i parë prej 14,000 eurosh, u pagua në datën e lidhjes së kontratës, më 11.11.2003, në zyrën noteriale, në prani të noterit;
- ii. kësti i dytë prej 45,000 eurosh, do paguhet brenda datës 15 janar të vitit 2004;
- iii. diferenca prej 3,400 eurosh, do paguhet nga porositësi më përpara marrjes në dorëzim nga ana e tij e apartamenteve të mësipërm, të përfunduar.

Më datë 11.12.2003, z. Gj.S dhe shoqëria “****” sh.p.k., lidhin shtesë kontrate sipërmarrje me nr. **, të redaktuar nga noteri Xh.H.

Referuar kësaj kontrate, në marrëveshje midis tyre, palët kanë rënë dakord që apartamentet e përshkruar në kontratën e sipërmarrjes, nr. *** dhe nr. **, të ngelen në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k., dhe kjo shoqëri t’i dorëzoj të përfunduar porositësit, z. Gj.S, po në të njëjtën godinë, apartamentin me nr. *** dhe nr. **, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimore 156 m². Palët deklarojnë se çmimi i këtyre apartamenteve mbetet i njëjtë, në vlerën prej 62,400 eurosh, nga të cilat janë paguar 14,000 euro, deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Gjithashtu, në këtë shtesë kontrate parashikohet se, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tjera të parashikuara në kontratën e sipërmarrjes, legalizuar me vërtetim nënshkrimi nr. **, datë 10.11.2003, mbeten të pandryshueshme ndërmjet palëve, me përjashtim të pikës 3.b) të kontratës ku kësti i dytë që duhet të paguaj porositësi nga 45,000 euro do të ndryshohet në 42,000 euro.

Më datë 07.01.2004, z. F.S, drejtues ligjor dhe administrator i shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., nëpërmjet deklaratës noteriale me nr. **, konfirmon se, shtetasi Gj.S i pagoi shoqërisë “****” këstin e dytë në shumën prej 42,000 euro.

Më datë 04.05.2007, z. F.S, drejtues ligjor dhe administrator i shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., nëpërmjet deklaratës noteriale me nr. **rep., konfirmon se, z. Gj.S i pagoi shoqërisë “****” vlerën prej 4,500 eurosh. Përveç kësaj vlere deklaroi se, porositësi (Gj.S) ka bërë punime në apartament me vlerë 600 euro, të cilat i llogariten si pagesë. Diferenca prej 1,300

² Me vendimin nr. **, datë 26.07.2002, të KR.T-së Tiranë, shoqëria ka marrë leje ndërtimi në shesh të miratuar për ndërtimin e një objekti 8 kate, me 1 kat parkim nëntokë, në rrugën e “****”.

eurosh do paguhet nga porositësi, me rastin e kalimit në pronësi të tij pranë ZVRPP-së Tiranë të dy apartamenteve të porositor.

Në dosjen e ZVRPP-së Tiranë, që lidhet me këtë pasuri, ndodhet vërtetimi i datës 01.11.2016, i lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., sipas të cilit konfirmohet se porositësi Gj.S, ka shlyer të gjitha detyrimet monetare ndaj kësaj shoqërie në lidhje me pronësinë e pasurive të paluajtshme të tipit apartament, në objektin e ndërtuar prej saj, të ndodhur në, ZK ***, nr. pasurie (pallat), nr. ***, “****”, Tiranë.

Më datë 16.11.2016, ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse dhe shtetasve Gj.S dhe Ana Gollosi, në cilësinë e palës blerëse, është lidhur kontrata e shitjes me nr. ***, e redaktuar nga noteri publik znj. E.T.

Objekti i kësaj kontrate, është kalimi i pronësisë nga shitësi tek blerësi, kundrejt pagimit të çmimit, të pronave të paluajtshme të llojit:

- i. “Apartament nr. ****”, me sipërfaqe 79 m², pasuri e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, me nr. pasurie ***, ndodhur në ZK ***, vol. ***, fq. ***, dhe pjesët në bashkëpronësi të detyrueshme të pasurisë (pallat) nr. ***, pasuri e ndodhur në, “****”, hyrja ***, apartamenti ***, Tiranë;
- ii. “Apartament nr. ****”, me sipërfaqe 63 m², pasuri e regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë, me nr. pasurie ***, e ndodhur në ZK ***, vol. ***, fq. ***, dhe pjesët në bashkëpronësi të detyrueshme të pasurisë (pallat) nr. ***, pasuri e ndodhur në “****”, hyrja ***, apartamenti ***, Tiranë.

Në nenin 3, të kësaj kontrate konfirmohet se çmimi i blerjes së sendeve objekt shitje, në shumën prej 62,400 eurosh, është likuiduar tërësisht nga blerësi tek shitësi.

Me shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2018, i jemi drejtuar noteres E.T duke i kërkuar kontratën e shitjes dhe dokumentacionin shoqërues të saj, të lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k., dhe shtetasve Gj.S dhe Ana Gollosi.

Noterja E.T., me shkresën e datës 16.10.2018, protokolluar me tonën me nr. *** prot., datë 18.10.2018, na dërgon një kopje të kësaj kontrate, nga ku vërejmë se ajo është e njëjtë në formë dhe në përmbajtje me kontratën e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.

Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues që i bashkëlidhet kontratës vërehet se ai është i njëjtë me dokumentacion e dorëzuar nga subjekti pranë ZVRPP-së Tiranë. Në dokumentacionin shoqërues të kësaj kontrate, gjendet edhe kopje e mandatar-këtimit, datë 05.11.2016, sipas të cilit shtetasja Ana Gollosi ka paguar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., këstin e fundit në vlerën prej 1,300 eurosh.

Konstatohet se, më datë 11.01.2017, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, në mbështetje të pikës 1 të nenit 34 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, si edhe bazuar në kontratën e sipërmarrjes dhe të shitjes, kanë kërkuar në ZVRPP-në Tiranë bashkimin e dy pasurive të mësipërme në një të vetme, me sipërfaqe të brendshme 142 m² dhe sipërfaqe për ambientet e përbashkëta 14 m². Subjekti i ka bashkëlidhur kësaj kërkesë certifikatat e dy pasurive dhe genplanin e pasurisë, të bashkuar në një të vetme.

Bazuar në kërkesën e bërë nga subjekti, ZVRPP-ja Tiranë ka bashkuar dy pasuritë (1) pasurinë nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, lloji i pasurisë apartament, me sipërfaqe 79 m²; dhe (2) pasurinë me nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, lloji i pasurisë apartament, me sipërfaqe 63 m².

Konfirmohet se, nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë, kartelat e këtyre dy pasurive mbajnë shënimin “*MBYLLUR*”.

Pas bashkimit të këtyre dy pasurive, është çelur kartela e pasurisë me nr. ***, vol. ***, fq. ***, lloji i pasurisë apartament, me sipërfaqe 142 m², që i përket subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj. Kjo është pasuria e vetme aktive e regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë, e cila është në bashkëpronësi të bashkëshortëve Ana Gollosi dhe Gj.S.

Për sa më sipër, Komisioni, ka konstatuar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë. Subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri.

24.2 Apartament³, me sipërfaqe 71,5 m², i ndodhur në, RR “**”, hyrja ***, apartamenti ***, Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë.**

- i. Vlera e deklaruar: 28.033 USD;
- ii. Pjesa në përqindje: 20 %, në bashkëpronësi me babanë, nënën, vëllain dhe motrën;
- iii. Burimi i krijimit: (1) të ardhura nga shitja e shtëpisë së mëparshme në Vlorë; dhe (2) të ardhurat nga emigracioni.

- Subjekti deklaron se, kjo pasuri është regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë, në ZK ***, nr. pasurie ***.

Mënyra e fitimit të pasurisë: Kontratë shitje me nr. ***, datë 02.12.2011.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 71,5 m², në rrugën “****”, në vlerën totale prej 28,033 dollarë, përfshirë këtu edhe dokumentacionin e shitjes së shtëpisë në Vlorë, e cila ka shërbyer si burim.

Hetimi i kryer nga Komisioni

ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 28.09.2018, na informon se nga verifikimi i bërë informacionit digjital dhe manual, si dhe dokumentacionit që disponon kjo zyrë, rezulton se në emër të shtetasve Ana Gollosi, N.G, S.G, S.G dhe O.G (bashkëpronarë), është regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasuria me të dhënat si më poshtë:

- i. pasuria me nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, apartament, me sipërfaqe 71.5 m² (pasuri aktive).

ZVRPP-ja Tiranë, nuk na ka dërguar kopje të kontratës së shitjes së kësaj pasurie, por na ka dërguar Urdhrin e Korrigjimit me nr. *** prot., me nr. ***, datë 12.12.2016, ku parashikohet se, sipas dokumentacionit të arkivuar në ZVRPP-në, në kontratën e shitjes me nr. ***, datë 02.12.2011, mbiemri i blerësve është Gollosi dhe jo Gjellosi. Po me këtë mbiemër është bërë korrigjimi dhe regjistrimi në regjistrin hipotekor nr. ***. Meqënëse mbiemri është afishuar gabim, bazuar në nenin 63 të ligjit nr. 33/2012, është urdhëruar korrigjimi i mbiemrit.

³ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI): (1) Çertifikatë pronësie nga ZVRPP Tiranë, datë lëshimi 01.12.2016; dhe (2) kontratë shitje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.12.2011, shoqëruar me vërtetimin hipotekor me nr. ***, dt. 29.9.2011 dhe nr. ***, datë 16.12.2011, të ZVRPP Tiranë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga vetë subjekti, rezulton se, më datë 02.12.2011, shtetasit Ana Gollosi, N.G, S.G, S.G dhe O.G, kanë lidhur kontratën e shitblerjes së pasurisë me nr. ***, të redaktuar nga noteri R. K, sipas të cilës kanë blerë nga shoqëria “***” sh.p.k., apartamentin me nr. ***, shkalla nr. ***, në katin e ***, të godinës ***-katëshe, ngjitur me Rr: “***”, me sipërfaqe 71.5 m² (pa përfshirë sipërfaqet e përbashkëta), të regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë, me nr. pasurie ***, në ZK nr. ***.

Referuar kësaj kontrate, palët fillimisht kanë rënë dakord sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. ***kol, datë 22.03.2002, të redaktuar nga notere L.Gj, se ky apartament do ti kalojë blerësve për shumën prej 28,033 USD, shumë e cila sipas deklaramit të palëve dhe vërtetimit të dokumenteve përkatëse të pagesës rezulton të jetë paguar nga ana e blerësve.

Për të konfirmuar vërtetësinë e deklarimeve të bëra lidhur me këtë pasuri, Komisioni i kërkoi subjektit që të depozitojë dokumentacionin e shitjes së shtëpisë në qytetin e Vlorës, që ka shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie, si edhe kontratën e sipërmarrjes me nr. ***, datë 22.03.2002, sipas së cilës është prenotuar kjo pasuri.

Pasi i janë dërguar rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit znj. Ana Gollosi, ka dërguar prapësimet e saj pranë Komisionit, ku ka shpjeguar në mënyrë analitike burimin e krijimit të kësaj pasurie si edhe ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar si edhe dokumentacion shtesë provues.

Subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka shpjeguar se, *kjo është pasuria e vetme që disponojnë prindërit e saj. Fillimisht sqaron se, me të ardhurat që ka përfutuar babai i saj si emigrant ekonomik në shtetin Grek që prej fundit të vitit 1992, në vitin 1993 ka privatizuar shtëpinë ku banonin, në Lushnje, sipas kontratës me nr. *** prot., datë 27.07.1993, të lidhur me Entin Kombëtar të Banesave. Kjo shtëpi është shitur në korrik të vitit 1995, për shumën prej 1,800,000 lekësh. Një vit më pas me të ardhurat e përfuturara nga shitja e kësaj shtëpie dhe të ardhurat nga emigracioni të babait të saj, kanë blerë një shtëpi në Vlorë me çmim blerje 2,100,000 lekë, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 10.07.1996. Më tej shpjegon se, shtëpia në Vlorë është shitur, më datë 23.01.2002, në vlerën prej 3,600,000 lekësh.*

Nga verifikimi i kontratës së shitjes së shtëpisë në Vlorë konstatohet se, pala shitëse, z. N.G, ia shet palës blerëse apartamentin me çmimin e caktuar në marrëveshje midis tyre që është 2,000,000 (dy milion lekë), shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Gjithashtu në këtë kontratë parashikohet se, pala shitëse i shet palës blerëse edhe materialet hidrosanitare dhe elektrike që ndodhen në banesë që kapin shumën 1,600,000 lekë, shumë e cila nuk përfshihet në çmimin e shitjes së banesës. Pra në total, babai i subjektit të rivlerësimit ka përfutuar shumën prej 3,600,000 lekësh nga shitja e apartamentit në Vlorë.

Me vlerën e përfutuar nga shitja e apartamentit në Vlorë, subjekti deklaron se babai i saj ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me nr. ***, datë 22.03.2002, me shoqërinë “***” sh.p.k., me anë të së cilës ka prenotuar këtë pasuri objekt hetimi.

Nga verifikimi i kësaj kontrate sipërmarrje rezulton se ajo është nënshkruar vetëm nga shtetasi N.G në cilësinë e porositesit dhe se në të parashikohet mënyra e pagesës si më poshtë:

- i. Pagesa në shumën prej 76 % ose 21,305 USD, do kryhet, më datë 25.03.2002;
- ii. Pagesa në shumën prej 19 % ose 5,326 USD, do të kryhet, më datë 02.06.2002;
- iii. Pjesa tjetër e mbetur në shumën prej 5% ose 1,402 USD, do të kryhet menjëherë pas marrjes në dorëzim të apartamentit.

Në vijim subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, mbi bazën e kësaj kontrate sipërmarrje, më datë 02.12.2011, është lidhur kontrata e shitjes së kësaj pasurie dhe se ka qenë vullneti i prindërve të saj që në kontratë të përfshiheshin si blerës edhe tre fëmijët (përfshirë dhe subjektin), pavarësisht se thotë se nuk kanë kontribuar aspak në krijimin e saj. Subjekti ka argumentuar se, dy këstet e para për blerjen e këtij apartamenti, 95 % e e shumës, është likuiduar nga babai i saj në periudhën që vëllai dhe motra e saj kanë qenë studentë, ndërsa ajo vetë ka qenë emigrante. Si përfundim, subjekti deklaron se kjo pasuri është krijuar vetëm me kontributet e prindërve të saj.

➤ Dokumentacioni provues i depozituar nga subjekti:

- i. Kontratë shitblerje (privatizimi) me nr. *** prot., datë 27.07.1993, dhe dokumentacionin shoqërues të saj;
- ii. Tre vërtetime nga ZVRPP-ja Lushnjë me nr. *** prot., datë 31.01.2019;
- iii. Deklaratë noteriale e shtetasit N.G, me nr. ***, datë 08.02.2019;
- iv. Kontratë shitblerje (pasurie të paluajtshme) me nr. ***, datë 10.07.1996, dhe dokumentacionin shoqërues të saj;
- v. Kontratë shitje (pasurie të paluajtshme) me nr. *** kol, datë 23.01.2002;
- vi. Kontratë sipërmarrje e datës 22.03.2002, legalizuar me vërtetim nënshkrimin nr. ***, redaktuar nga noteri publik, z. L.Gj.
- vii. Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme (apartament) me nr. ***, datë 02.12.2011;
- viii. Kopje të diplomave të vëllait dhe motrës së subjektit të rivlerësimit.

Në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore lidhur me këtë pasuri dhe mënyrën e përfitimit të 20 % të saj, ndër të tjera subjekti pretendoi se kjo ishte një formë e zgjedhur nga babai i subjektit, i cili pas këshillimit të noterit ka vendosur që fëmijët ti bëj bashkëpronarë tek kjo pasuri dhe se automatikisht me trashëgimi ligjore, kjo pasuri mbartet në të ardhmen në emrat e tre fëmijëve.

Komisioni vlerëson se, në të tilla rrethana faktike dhe juridike, nuk duken bindëse dhe të bazuara në prova shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit se nuk ka kontribut në krijimin e kësaj pasurie, kjo pasi:

Së pari, fitimi i kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht të 1/5 pjesë të saj, është realizuar nëpërmjet kontratës noteriale të shitjes me nr. nr. ***, datë 02.12.2011, ku znj. Ana Gollosi, paraqitet në cilësinë e palës blerëse të kësaj pasurie, duke u bërë bashkëpronare e këtij apartamenti. Referuar nenit 659 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë: *“Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”*. Neni 660 i Kodit Civil parashikon se: *“Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi”*. Ndërsa neni 690 i Kodit Civil parashikon se: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”*. Në këtë kuptim, në këtë kontratë parashikohet se, çmimi për blerjen e këtij apartamenti është likuiduar jashtë zyrës noteriale, por në asnjë rast nuk është evidentuar fakti i pretenduar nga subjekti se nuk ka kontribut në blerjen e saj.

Së dyti, subjekti i rivlerësimit është bashkëpronare tek ky apartament dhe gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronësisë në pjesë, sipas parashikimeve të Titullit III, Kreu I, të Kodit Civil.

Së treti, bazuar në nenin 360 dhe 361, të Kodit Civil fëmijët janë trashëgimtarë ligjorë që thërriten në radhë ta parë në trashëgim. Si rrjedhim, nuk qëndron arsyetimi i dhënë nga subjekti se, ajo vëllai dhe motra e saj janë përfshirë në kontratë shitblerje për efekt trashëgimie.

Së katërti, me dorëzimin e deklaratës “Vetting” subjekti ka deklaruar si burim krijimi të saj të ardhurat nga shitja e apartamentit në Vlorë dhe të ardhurat nga emigracioni, pa përcaktuar shumën konkrete nga secili burim dhe pa i specifikuar ato. Si rrjedhim, vlerësohen të ardhurat nga emigracioni janë të ardhura të subjektit të përfituara si emigrante ekonomike në shtetin grek.

Së fundmi, në deklaratën “Vetting” subjektin nuk ka deklaruar se nuk ka kontribut në krijimin e kësaj pasurie dhe se gjithashtu nuk ka deklaruar si dhurim përfitimin e 1/5 pjesë të saj, në përputhje me germën “F”, pika 1, neni 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, Komisioni, vëren se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë. Gjithashtu Komisioni vlerëson se nuk provohen pretendimet e subjektit se nuk ka kontribut në krijimin e kësaj pasurie. Si rrjedhim, në analizën financiare do të përlllogaritet si shpenzim i kryer nga ana e subjektit, pagesa e vlerës prej 1/5 për blerjen e kësaj pasurie.

24.3 Automjet, tip “Hyundai Tucson”⁴, me targë ***

- i. Vlera e deklaruar: 20,500 euro;
- ii. Pjesa në përqindje: 50%, në bashkëpronësi me bashkëshortin.
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga emigracioni.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e automjetit në shumën 20,500 euro.

Hetimi i kryer nga Komisioni

DPSHTRR, me shkresën nr. *** prot., datë 25.09.2018, na konfirmon se shtetasja Ana Golloshi aktualisht ka në bashkëpronësi me shtetasin Gj.S, mjetin me targë TR ***.

DPSHTRR, me shkresën nr. *** prot., datë 28.09.2019, na dërgon dosjen e plotë të mjetit me targë TR ***. Rezulton se, nëpërmjet faturës tatimore me nr. *** (numri serial i faturës ***), datë 14.04.2008, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, kanë blerë nga shoqëria “****”, autoveturën e markës “Hyundai Tucson”, për vlerën prej 2,514,530 lekësh, shumë e cila konvertuar me kursin mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2008, është përafërsisht në vlerën prej 20,500 eurosh.

⁴ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI): -Leje qarkullimi datë 15.04.2008 të mjetit Hyundai Tucson, shoqëruar me Faturën doganore e datë 18.03.2008, si dhe me Faturën tatimore shitje e dt. 14.4.2008, me vlerë 20.500 euro.

Komisioni konstaton se, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR. Subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri

Shqyrtimi i pretendimeve të subjektit, që lidhen me analizat financiare:

Pasi i është kaluar barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, ka dërguar prapësimet e saj pranë Komisionit, duke ngritur pretendime lidhur me përllogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera nga ana e saj.

Trupi gjykues vlerësoi me objektivitet të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe reflektoi ndryshimet përkatëse, në analizat financiare përfundimtare për periudhën objekt hetimi. Analiza e kryer nga Komisioni lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit të përcjella me prapësimet e tij, në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë:

- i. Siç e trajtuam edhe më sipër, subjekti ka pretenduar se nuk ka kontribut financiar për blerjen e apartamentit, ndodhur në Rr: “***”, Tiranë. Ky pretendim nuk është marrë në konsideratë nga ana e këtij Komisioni, pasi ka karakter deklarativ dhe nuk është i bazuar në prova.
- ii. Subjekti ka pretenduar rillogaritjen e të ardhurave të përfituara përgjatë viteve 2002 dhe 2003, vite të cilat ka qenë në emigracion. Komisioni, pasi vlerësoi provat e paraqitura konstatoi se, për vitin 2002 janë përllogaritur saktë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të subjektit, ndërsa për vitin 2003 janë marrë në konsideratë pretendimet e subjektit dhe janë reflektuar të ardhurat e shtuara për këtë vit në analizën financiare të kësaj periudhe.
- iii. Subjekti ka pretenduar të ardhura ta pallogaritura, të përfituara nga asistenca për periudhën 07.01.2005 deri 10.01.2006. Për të vërtetuar këtë fakt, subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 10.01.2019, të lëshuar nga Zyra e Punës Athinë, Greqi, sipas së cilës konfirmohet fakti se subjekti ka përfitur asistencë për këtë periudhë, por nuk paraqitet vlera e përfitur. Me anë të deklaratës noteriale nr. ***, datë 16.01.2019, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar se për këtë periudhë ka përfitur 350 euro në muaj, në total vlerën prej 4,900 eurosh. Lidhur me këtë pretendim, Komisioni, vlerësoi se është i natyrës deklarative dhe se shuma e deklaruar si e përfitur nga asistenca nuk mbështet në dokumentacion provues dhe si rrjedhojë nuk do merret në konsideratë në analizën financiare.
- iv. Subjekti ka pretenduar të ardhura nga prindërit e bashkëshortit të subjektit, përgjatë periudhës që kanë qenë emigrant ekonomik në shtetin Grek dhe gjithashtu ka kërkuar të përfshihen në analizën financiare të ardhurat e tyre të përfituara nga pensioni i pleqërisë në Republikën e Shqipërisë. Nga ana e subjektit është kërkuar thirrja si dëshmitare e znj. N.S (nëna e bashkëshortit të subjektit), duke pretenduar se në asnjë moment nuk është marrë parasysh fakti se nëna dhe babai i bashkëshortit të subjektit, kanë jetuar me ta gjatë periudhës së emigracionit. Bazuar në pikën 6 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, pasi u shqyrtua kërkesa e subjektit të rivlerësimit për thirrjen si dëshmitare të znj. N.S, trupi gjykues vlerësoi se: - Subjektit në vazhdimësi nëpërmjet pyetësorëve të dërguar i është kërkuar të na paraqesë çdo dokumentacion justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e

përfituara nga ana e saj dhe familjarëve të saj, përfshirë këtu dhe shtetases N.S, e cila është në certifikatë familjare me subjektin. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion për të ardhurat e përfituara nga pensioni i pleqërisë nga znj. N. S dhe z. J.S, të ardhura të përfituara në Republikën e Shqipërisë. Subjekti nuk paraqiti dokumentacion tjetër, lidhur me të ardhura të përfituara nga prindërit e bashkëshortit të subjektit në shtetin Grek. Nisur nga ky fakt, Komisioni në analizën financiare nuk ka përfshirë të ardhurat e përfituara prej tyre nga pensioni i pleqërisë, por gjithashtu nuk ka përfshirë në llogaritje shpenzimet e tyre për jetesë, duke vlerësuar se të ardhurat nga pensioni mund të mbulojnë vetëm shpenzimet minimale të jetesës. Komisioni, me dërgimin e rezultateve të hetimit në asnjë rast nuk ka vënë në dyshim se znj. N.S dhe i ndjeri z. J.S kanë jetuar në shtetin grek së bashku me subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e subjektit. Për këto arsye, bazuar në gurmën d), të pikës 5 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues me anë të vendimit të ndërmjetëm nr. ***, datë 31.01.2019, ka vendosur të refuzojë kërkesën e paraqitur nga subjekti, pasi ka vlerësuar se me anë të kësaj kërkesë pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit. Si përfundim, Komisioni ka vlerësuar se nuk do të përfshin në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga pensioni i pleqërisë nga znj. N.S dhe z. J.S.

- v. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij ka pretenduar se në shpenzimet e llogaritura nga Komisioni përgjatë periudhës që kanë jetuar në Greqi janë përllogaritur shpenzime qiraje, për të cilat pretendon se janë deklaruar dhe mbajtur si shpenzime, konfirmuar kjo nga formularët e vetëdeklarimit të ardhurave në Ministrinë së Financave të Greqisë, të depozituara si provë nga subjekti si provë pranë këtij Komisioni. Lidhur me këtë pretendim, Komisioni argumenton se në shpenzimet vjetore janë llogaritur vetëm shpenzimet minimale të jetesës për konsum familjar pa përfshirë shpenzime qiraje.
- vi. Gjithashtu subjekti ka pretenduar se nuk janë llogaritur saktë të ardhurat e bashkëshortit të saj, të përfituara nga puna e kryer si ekspert mjeko-ligjor dhe si ekspert i jashtëm i rrethit Kavajë, pasi ka pasur mospërputhje në informacionet e mëparshme të dërguara nga Insituti i Mjekësisë Ligjore. Lidhur me këtë pretendim, subjekti ka depozituar si provë vërtetimin me nr. *** prot., datë 04.11.2016, të Institutit të Mjekësisë Ligjore, lidhur me të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, IML, me shkresën nr. *** prot., datë 05.02.2019, ka ridërguar pranë Komisionit të dhënat e saktësuar lidhur të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit, të cilat janë të njëjta me vërtetimin e paraqitur nga subjekti. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezulton se, janë pasqyruar edhe të ardhura të përfituara nga bashkëshorti i subjektit për periudhën 2014 - 2016 të përfituara si ekspert i jashtëm pranë këtij institucioni. Komisioni çmon se, të ardhurat e pasqyruara në këto vërtetime të përfituara si ekspert i jashtëm pranë IML-së nuk do përfshihen në llogaritjen e të ardhurave, pasi duke qenë se për këtë periudhë bashkëshorti i subjektit ka qenë i regjistruar si person fizik në organin tatimor, këto të ardhura duhet të jenë deklaruar si të ardhura të përfituara nga subjekti tregtar “****” me NIPT ***. Komisioni, ka përfshirë në analizën financiare fitimin e subjektit “****” me NIPT ***, sipas shkresës së ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë. Ndërsa lidhur me të ardhurat e tjera të pasqyruara në vërtetimin e paraqitur nga subjekti

dhe shkresën e ardhur nga IML, do të përfshihen në analizën financiare nga ana e Komisionit.

Për sa u analizua më sipër, do të merren në konsideratë nga Komisioni në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve për analizën financiare që i përket periudhës deri në fund të vitit 2008, për analizën financiare që i përket periudhës 01.01.2009 - 27.01.2017, po ashtu edhe në analizën financiare përmbledhëse.

Analizë financiare lidhur me pasuritë e krijuara deri në fund të vitit 2008⁵

Meqenëse, subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së, Komisioni kreu analizë financiare lidhur me mundësitë financiare që, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë pasur për krijimin e pasurive për periudhën deri në fund të vitit 2008, që i përkasin pasurive të analizuara si më sipër si edhe likuiditeteve të evidentuara nga ana jonë si gjendje në sistemin bankar.

Të ardhurat: Komisioni, në mënyrë të përsëritur i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit që të paraqesë dokumentacionin e duhur ligjor, lidhur me të ardhurat e përfituara në emigracion nga ana e saj dhe e familjarëve të saj.

Referuar dokumentacionit ligjor justifikues të dorëzuar nga ana e subjektit, për të ardhurat e përfituara nga emigracioni në Greqi, rezultojnë se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë përfituar këto të ardhura:

- i. Për periudhën 1995 - 2002, rezultojnë të konfirmuara nga Shërbimi Publik i Financave në Greqi, të ardhurat në vlerën prej 61,021 eurosh;
- ii. Për periudhën 2003 - 2005, sipas konfirmimit nga Ministria e Punës Greqi, vetëm për subjektin e rivlerësimit rezultojnë të ardhura për të cilat janë paguar kontribute, në vlerën prej 30,833 eurosh.

Të ndara në vite, të ardhurat e përfituara nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, për periudhën 1996 - 2005, bazuar në dokumentacionin ligjor, janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Tabela e të ardhurave nga emigracioni

Periudha (viti)	shuma DPX (dhrhmi)	shuma euro (konvertuar 1euro = 340,75 DPX)
1996	296,523	870.2
1997	1,137,138	3,337.2
1998	2,375,816	6,972.3
1999	2,248,587	6,598.9
2000	4,347,459	12,758.5
2001	49,26,127	14,456.7

⁵ Tre pasuritë e përshkruar si më sipër si edhe gjendjet e likuiditeteve të evidentuara në bankë në fund të këtij viti.

2002	0	16,027.0
2003	0	17,363.6
2004		12,888.0
2005	0	581.5
Totali	15,331,650	91,853.9

- Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin ligjor provues të paraqitur pranë Komisionit, rezulton se të ardhurat totale të përfituara nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, gjatë periudhës që kanë qenë në emigracion, janë në vlerën totale prej rreth 91,854 eurosh. Gjithashtu, bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje (vërtetime të ardhurash), rezultoi se:

- i. Të ardhurat e subjektit nga pagat për periudhën 2005 - 2008, janë në vlerën prej 1,791,529 lekësh;
- ii. Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga pagat për periudhën 2003 - 2008, janë në vlerën prej 2,346,848 lekësh.

Shpenzimet: Komisioni, vlerëson se për periudhën që subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj kanë qëndruar në Greqi, shpenzimet minimale për konsum familjar do llogariten në vlerën prej 6,000 eurosh në vit, përkatësisht vlera prej 500 eurosh në muaj.

Bazuar në përbërjen familjare (pa përfshirë prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit), shpenzimet e jetesës, minimale për konsum familjar, për periudhën që subjekti ka qëndruar në Shqipëri (vitet 2005 -2008), janë llogaritur në total në vlerën prej 2,049,918 lekësh.

Për këtë periudhë, subjekti gjithashtu ka deklaruar se ka kryer edhe shpenzime për arredimin e shtëpisë, në total në vlerën prej 2,100,000 lekësh.

- Të dhënat lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet, deri në fund të vitit 2008, reflektohen në tabelën e mëposhtme:

naliza financiare për periudhën 1996 - 31.12.2008

Përshkrimi	Shuma në lekë
Të ardhura nga emigracioni, periudha 1996 - 2002, sipas Shërbimit Publik të Financave	8,155,457
Të ardhura për të cilat janë paguar Sigurimet Shoqërore, periudha 2003 - 2005, sipas shkresës së Ministrisë së Punës së Greqisë	3,907,787
Të ardhurat neto nga pagat dhe shpërblimet e subjektit, periudha 2005 - 2008	1,791,529
Të ardhurat nga pagat + shpërblimet e bashkëshortit të subjektit, periudha 2003 - 2008	2,346,848
Të ardhura të tjera	64,300
Total të ardhura	16,265,921
Pagesë arredimi, e vetëdeklaruar	2,100,000
Pagesë shpenzime jetese Greqi (1996 - 2004)	6,843,960
Pagesë shpenzime jetese Tiranë, Shqipëri (2005 - 2008)	2,049,918
Total shpenzime	10,993,878

Ndryshim mj.monetare gjendje fillim - gjendje fund periudhe (0 -1,598,429 lekë)	-1,598,429
Mjete monetare të disponueshme (1)	3,673,613
Pagesa për blerje apartament në Rr. “****”, në bashkëpronësi me pjesë 1/5, viti 2002	756,723
Blerje pasurie apartament, vlera 62.400 euro, kontrate viti 2003	8,339,760
Pagesa për blerje pasurie automjeti, tip “Hyundai Tucson”, vlera 20.500 euro kontratë viti 2008	2,537,900
Total pasuri	11,634,383
Detyrime 1300 euro, likuiduar me vonë për apartamentin	-173,745
Pasuri neto (2)	11,460,638
Balanca e fondeve (1-2)	-7,787,025

Nga sa më sipër, Komisioni konstaton se, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera deri në fund të vitit 2008.

Depozitat në Bankën Kombëtare Tregtare

24.4 Depozitë pranë “BKT”-së⁶.

- i. Vlera e deklaruar: 1,252,215 lekë, nga të cilat interesa neto për vitin 2016 janë 51,215 lekë;
- ii. Pjesa në përqindje: 100 % në emër të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga kursimet nga puna në emigracion.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për depozitën pranë “BKT”-së, në shumën prej 1,251,215 lekësh.

24.5 Depozitë pranë “BKT”-së⁷.

- i. Vlera e deklaruar: 2,189,091.15 lekë, nga të cilat interesat neto për vitin 2016 janë 36,442.18 lekë;
- ii. Pjesa në përqindje: 100% në emër të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga kursimet nga puna në emigracion.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për depozitën pranë “BKT”-së, në shumën prej 2,189,091 lekësh.

Hetimi i kryer nga Komisioni

“BKT”-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 02.10.2018 na konfirmon se, subjekti i rivlerësimit ka pranë kësaj banke llogarinë, me të dhënat si më poshtë:

⁶ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) vërtetim nga “BKT” nr. ***, datë 18.01.2017; dhe (2) nxjerrje llogarie nga “BKT”-së, më datë 26.11.2014.

⁷ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) vërtetim nga “BKT” nr. ***, datë 18.01.2017; dhe (2) nxjerrje llogarie e “BKT”-së, në datë 20.01.2017.

Nr. Llogarisë	Monedha	Statusi i llogarisë	Gjendja Aktuale e Llogarisë	Shënime të tjera
***	Lekë	Aktive	3,468,368.88 (lekë)	Prej të cilave 2,217,153.18 lekë janë investuar në depozitë me afat 1 vit, me datë maturimi 15.07.2019, dhe 1,251,215.70 janë të investuara në depozitë me afat 2 vjet, me datë maturimi 27.11.2018.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ana e kësaj banke (nxjerrjes së llogarisë me nr. ***), rezulton se subjekti i rivlerësimit:

- i. më datë 26.11.2014, ka depozituar *cash* shumën 1,200,000 lekë;
- ii. më datë 27.11.2014, shuma prej 1,200,000 lekësh është vendosur në depozitë me afat;
- iii. më datë 09.04.2015, ka depozituar *cash* shumën prej 1,000,000 lekësh;
- iv. më datë 10.04.2015, shumën prej 1,000,000 lekësh e ka kaluar në depozitë me afat.
- v. më datë 10.07.2015, ka depozituar *cash* shumën prej 1,150,000 lekësh;
- vi. më datë 10.07.2015, është rikthyer principal i depozitës së çelur, më datë 09.04.2015, në vlerën prej 1,002,649 lekësh;
- vii. më datë 13.07.2015, është hapur një depozitë e re me vlerë 2,152,649 lekë, nga bashkimi i shumës prej 1,002,649 lekësh (që përfaqëson depozitën e krijuar, më datë 09.04.2015, kthyer më datë 10.07.2015) dhe shumës prej 1,150,000 lekësh (që përfaqëson vlerën e depozituar *cash* më datë 10.07.2015).

Komisioni konstaton se, përputhen vlerat e deklaruara të këtyre depozitave (në momentin e deklarimit, datë 27.01.2017), me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “BKT”-ja.

Nisur nga fakti që të ardhurat e dokumentuara të përfituara nga emigracioni në Greqi nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të mëparshme analizuar sa më lart, Komisioni vlerëson se, subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e këtyre depozitave pranë “BKT”-së.

24.6 Depozitë pranë “Societe Generale Albania”.⁸

- i. Vlera e deklaruar: 1,089,896 lekë;
- ii. Pjesa në përqindje: 100% në emër të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga kursimet nga puna në emigracion.

⁸ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): -Lëvizjet e llogarisë së znj. Ana Golloshi, nga datë 28.01.2013 deri 18.01.2017, lëshuar nga “Societe Generale Albania”, në datë 18.01.2017, si dhe historikun e lëvizjeve në këtë llogari.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për depozitën pranë “Societe Generale Albania”, në shumën prej 1,089,896 lekësh.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Referuar të dhënave të dërguara nga “Societe Generale Albania”, me shkresën nr. ***, datë 06.12.2018, kjo llogari depozitë është krijuar, më datë 28.01.2013, në vlerë 1,000,000 lekë.

Nga verifikimi i kësaj llogarie, të ardhura nga interesat kanë qenë :

- i. datë 28.01.2014, të ardhura nga interesi neto, vlera prej 45,900 lekësh;
- ii. datë 28.01.2015, të ardhura nga interesi neto vlera prej 25,781 lekësh;
- iii. datë 28.01.2016 të ardhura nga interesi neto vlera prej 18,215 lekë;

Kjo llogari ka filluar të krijohet që në vitin 2006 dhe konfirmohet se, më datë 27.01.2017, gjendja e saj është sipas deklaratimit të subjektit.

Komisioni konstaton se, përputhet vlera e deklaruar e kësaj depozite (në momentin e deklaratimit datë 27.01.2017), me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Societe Generale Albania”.

24.7 Depozitë pranë “Credins Bank”⁹

- i. Vlera e deklaruar: 10,397.45 euro;
- ii. Pjesa në përqindje: 100 % në emër të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga kursimet nga puna në emigracion.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për depozitën në “Credins Bank”, në shumën prej 10,397.45 eurosh.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Referuar të dhënave nga “Credins Bank”, të dërguara me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2018, kjo depozitë me afat 36 muaj (llogaria me nr. *** në euro në emër të znj. Ana Golloshtit), është krijuar në datë 05.08.2016, nga mbyllja e dy depozitave në të njëjtën bankë në emër të subjektit të rivlerësimit, përkatësisht (1) llogaria nr. *** në euro, në vlerë 7,581.02 euro (depozitë në euro me afat 3 muaj, filluar në vitin 2012); si dhe (2) llogaria nr. *** në euro në vlerë 2,816.43 euro (depozitë në euro me afat 1 muaj, filluar në vitin 2011).

⁹ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): -Nxjerrje llogarie e depozitës në “Credins Bank”, datë 18.01.2017.

Komisioni konstaton se, përputhet vlera e deklaruar e kësaj depozite (në momentin e deklarimit datë 27.01.2017), me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”. Nisur nga fakti që të ardhurat e dokumentuara të përfituara nga emigracioni në Greqi nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të mëparshme analizuar sa më lart, Komisioni vlerëson se, subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e kësaj depozite në “Credins Bank”.

24.8 Llogari rrjedhëse e kreditimit të pagës në “Raiffeisen Bank”.¹⁰

- i. Vlera e deklaruar: 81,675.45 lekë;
- ii. Pjesa në përqindje: 100 % në emër të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga pagat.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si edhe me përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

“Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 18.09.2018, na konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka llogari page me nr. ***, me gjendje 1,058,647.10 lekë.

Nga verifikimi i kësaj llogarie, konfirmohet se gjendja e saj në datën e dorëzimit të deklaratës së subjektit pranë ILDKPKI-së është në vlerën prej 81,675 lekësh.

Komisioni konstaton se, përputhet vlera e deklaruar e kësaj llogarie (në momentin e deklarimit, më datë 27.01.2017), me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

24.9 Gjendje *cash* jashtë sistemit bankar.

- i. Vlera e deklaruar: 1,400,000 lekë;
- ii. Pjesa në përqindje: 50 %, në bashkëpronësi me bashkëshortin;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga kursimet nga emigracioni.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor, lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e gjendjes *cash*, në shumën prej 1,400,000 lekë.

Konkluzioni i Komisionit, lidhur me këtë pasuri:

Nisur nga fakti që të ardhurat e dokumentuara të përfituara nga emigracioni në Greqi nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të mëparshme analizuar sa më lart, Komisioni vlerëson se, subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e gjendjes *cash* në shumën prej 1,400,000 lekë.

¹⁰ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI): -Nxjerrje llogarie e Raiffeisen Bank, datë 24.01.2017.

Pasuri të deklaruara veçmas nga personi i lidhur, z. Gj.S.¹¹

24.10 Apartament¹², me sipërfaqe 42 m², ndodhur në Rr: “****”, nr. ***, shkalla ***, kati ***, Vlorë.

- i. vlera e deklaruar: 6,220 lekë, pasuri e parivlerësuar;
- ii. Pjesa në përqindje: 100 %.

Mënyra e fitimit të pasurisë: Trashëguar me dëshmi trashëgime testamentare nga halla e tij, E.S., e cila e kishte fituar këtë pasuri në bazë kontrate privatizimi.

- Sipas vetëdeklarimit, ky apartament është i regjistruar në regjistrat publik të ZVRPP-së Vlorë, me nr. pasurie ***.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Vlorë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

ZVRPP-ja Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2018, ndër të tjera na konfirmon se, në emër të shtetasi Gj.S është e regjistruar pasuria e llojit apartament, me sipërfaqe 42 m², e ndodhur në ZK nr. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Vlorë konstatohet se, kjo pasuri është përfituar nga shtetasi Gj.S nëpërmjet lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë testamentare sipas vendimit nr. ***, datë 25.05.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për sa më sipër, Komisioni konstaton se, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Vlorë. Rezulton se, janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri.

24.11 Apartament¹³, me sipërfaqe 106 m², i ndodhur në lagjen “****”, pallati nr. ***, shkalla nr. ***, ap. nr. ***, Vlorë.

- i. vlera e deklaruar: nuk ka deklaruar vlerë, por se është shkëmbyer me truall;
- ii. Pjesa në përqindje: 33.33 %, në bashkëpronësi më nënën dhe motrën.

Mënyra e fitimit të pasurisë: Trashëguar pas vdekjes së babait të tij, i cili e kishte fituar këtë pasuri me kontratën nr. ***, datë 25.08.201, nga shkëmbimi i një trualli të kthyer me vendim nr. ***, datë 28.12.1994, të KKK Pronave Vlorë.

¹¹ nuk janë pasqyruar pasuritë e deklaruara më parë nga subjekti i rivlerësimit në bashkëpronësi me bashkëshortin e saj.

¹² Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) Certifikatë pronësie e ZVRPP-së Vlorë, datë lëshimi 11.07.2016; (2) Vendim nr. *** Akti, datë 25.05.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dhe (3) Kontratë privatizimi banese, datë 15.09.2004.

¹³ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) Certifikatë pronësie e ZVRPP-së Vlorë, datë lëshimi 13.01.2012, kartelën e pasurisë dhe hartën treguese; (2) Vendim nr. ***, datë 28.12.1994, të KKK Pronave Vlorë; dhe (3) Kontratë shkëmbimi nr. ***, datë 25.08.2011.

- Sipas vetëdeklarimit, ky apartament është i regjistruar në regjistrat publik të ZVRPP-së Vlorë, me nr. pasurie ***.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Vlorë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

ZVRPP-ja Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2018, ndër të tjera na konfirmon se, në emër të shtetasve N.S, Gj.S dhe D.S rezultojnë të regjistruar pasuria e llojit apartament me sipërfaqe 106 m², e ndodhur në ZK nr. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Vlorë konstatohet se, kjo pasuri është përfituar nga shtetasit N.S, Gj.S dhe D.S nëpërmjet lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë ligjore të të ndjerit J. S, sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me nr. ***, datë 22.11.2011. Gjithashtu, nga verifikimi i kartelës së pasurisë vërehet se kjo pasuri fillimisht është regjistruar, më datë 08.09.2011, në emër të shtetasit J. S, ku në rubrikën “*Shënime*” është shënuar “*K. SHKËMBIMI*”.

Megjithëse ZVRPP-ja Vlorë nuk na ka dërguar referencën e plotë e kësaj pasurie, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga vetë subjekti rezultojnë se kjo pasuri është përfituar nga i ndjeri z. J.Z, nëpërmjet kontratës së shkëmbimit me nr. ***, datë 25.08.2011, të lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., të redaktuar nga notere J.V. Shtetasi J.S, ka shkëmbyer me shoqërinë “****” sh.p.k., truallin e përfituar sipas vendimit nr. ***, datë 28.12.1994, të KKKP-së Vlorë, me apartamentin me sipërfaqe 106 m², ndodhur në ZK nr. ***, me nr. pasurie ***, vol ***, fq ***.

Për sa më sipër, Komisioni konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Vlorë. Rezultojnë se, janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri.

24.12 Apartament¹⁴, me sipërfaqe **71.42 m²**, i ndodhur në , Rr: “****”, nr. ***, shkalla ***, kati ***, Vlorë,

- i. vlera e deklaruar: 3,014,538.2 lekë, rivlerësuar më datë 29.03.2012;
- ii. Pjesa në përqindje: 33.33 %, në bashkëpronësim më nënën dhe motrën.

Mënyra e fitimit të pasurisë: Trashëguar pas vdekjes së bashkëshortit J.S, i cili e kishte përfituar këtë pasuri me privatizim në vitin 1993.

- Sipas vetëdeklarimit, ky apartament është i regjistruar në regjistrat publik të ZVRPP-së Vlorë, me nr. pasurie ***.

¹⁴ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratën (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) Certifikatë pronësie e ZVRPP-së Vlorë, datë lëshimi 28.03.2012; (2) kartelën e pasurisë; (3) Kontratë privatizimi banese, datë 09.06.1993; (4) Vendim me nr. *** Akti, datë 22.11.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (5) Certifikatë familjare dhe certifikata e vdekjes së babait.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Vlorë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

ZVRPP-ka Vlorë, me shkresën nr. ***prot., datë 27.09.2018, ndër të tjera na konfirmon se, në emër të shtetases M.S (e bija e subjektit të rivlerësimit) rezulton e regjistruar pasuria e llojit apartament, me sipërfaqe 71.4 m² ndodhur në ZK nr. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, fq ***, që i përket pasurisë objekt hetimi.

Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se, kjo pasuri fillimisht është përfituar nga shtetasi J.S, nëpërmjet kontratës së privatizimit të banesës, të datës 09.06.1993. Më tej konstatohet se, kjo pasuri është përfituar nga shtetasit N.S, Gj.S dhe D.S nëpërmjet lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë ligjore të të ndjerit J.S, sipas vendimit nr. ***, datë 22.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë,

Me anë të kontratës së dhurimit me nr. ***, datë 04.11.2017, të redaktuar nga noteri A. Xh, rezulton se kjo pasuri i është dhuruar shtetases M.S, e bija e subjektit të rivlerësimit, dhe është regjistruar në emër të saj, më datë 06.12.2017, pranë ZVRPP-së Vlorë.

Noteri A.Xh, me shkresën e datës 05.11.2018, protokolluar me tonën nr. *** prot., datë 08.11.2018, na dërgon një kopje të kësaj kontrate, nga ku vërejmë se ajo është e njëjtë në formë dhe në përmbajtje me kontratën e administruar në dosjen e ZVRPP-së Vlorë.

Për sa më sipër, Komisioni konstaton se përputhet deklarimi i bërë me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Vlorë, për gjendjen e kësaj pasurie në momentin e deklarimit. Rezulton se, janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri. Kjo pasuri tashmë është e regjistruar në emër të personit të lidhur M.S, e bija e subjektit të rivlerësimit.

24.13 Automjet, tip “SMART Coupe”¹⁵, me leje qarkullimi me nr. *, me targë ***.**

- i. Vlera e deklaruar: 2,700 euro;
- ii. Pjesa në përqindje: 100 % në emër të bashkëshortit të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga mësimdhënia në Fakultetin e Infermierisë.

Mënyra e fitimit të pasurisë: Kontratë shitblerje me nr. ***, datë 15.07.2014.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR.

Hetimi i kryer nga Komisioni

¹⁵ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) Leje qarkullimi, datë 06.07.2014; (2) kontratë shitblerje me nr. ***, datë 15.07.2014; dhe (3) deklarata doganore e muajit korrik 2004.

DPSHTRR, me shkresën nr. *** prot., datë 25.09.2018, na konfirmon se shtetasi Gj.S ka në pronësi, mjetin me targë ***.

DPSHTRR, me shkresën nr. *** prot., datë 28.09.2019, na dërgon dosjen e plotë të mjetit me targë ***. Nga verifikimi i dosjes së këtij mjeti rezulton se, nëpërmjet dokumentit kontratë shitje me nr. ***, datë 15.07.2014, të redaktuar nga notere Sh.Gj, shtetasi Gj.S ka blerë nga shtetasi E.Xh, autoveturën e markës Smart, të tipit Coupe, për vlerën prej 2,700 euro.

Me shkresën nr. *** prot., datë 17.10.2018, i jemi drejtuar noteres Sh.Gj duke i kërkuar të na vejë në dispozicion kontratën e shitjes me nr. ***, datë 15.07.2014 dhe dokumentacionin shoqërues të saj.

Noterja Sh.Gj, me shkresën e datës 17.10.2018, protokolluar me tonën me nr. *** prot., datë 30.10.2018, na dërgon një kopje të kësaj kontrate, nga ku vërejmë se ajo është e njëjtë në formë dhe në përmbajtje me kontratën e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe që gjendet në dosjen e DPSHTRR.

Për sa më sipër, Komisioni, konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR. Rezulton se, janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri.

Depozita dhe llogaria rrjedhëse në “Credins Bank”.

24.14 Depozitë pranë “Credins Bank”¹⁶.

- i. Vlera e deklaruar: 2,500,000 lekë;
- ii. Pjesa në përqindje: 100 % në emër të bashkëshortit të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga puna në emigracion.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për depozitën në “Credins Bankën” në shumën prej 2,500,000 lekësh.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Referuar të dhënave të dërguara nga “Credins Bank”, kjo depozitë është me afat 36 mujor dhe është krijuar, më datë 21.07.2016, në emër të bashkëshortit të subjektit, në llogarinë me nr. ***.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ana e kësaj banke, rezulton se kjo depozitë është formuar nga dy transferta të kryera, (1) nga llogaria në emër të nënës së bashkëshortit të subjektit, më datë 03.05.2016, në vlerën prej 705,328 lekë; (2) transfertë nga bankë tjetër, më datë 20.07.2016, në vlerën prej 715,000 lekësh, si dhe (3) një derdhje *cash*, më datë 20.07.2016, në vlerë 1,100,000 lekë.

¹⁶ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI): (1) konfirmim nga Credins Bank me nr. *** prot., datë 23.01.2017; dhe (2) njerre llogarie nga Credins Bank.

24.15 Llogari rrjedhëse në “Credins Bank”¹⁷.

- i. Vlera e deklaruar: 20,300 lekë;
- ii. Pjesa në përqindje: 100 % në emër të bashkëshortit të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga puna në emigracion.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.

Nga verifikimi i përgjigjes së ardhur nga “Credins Bank”, konfirmohet gjendja e deklaruar e kësaj llogarie rrjedhëse.

Konkluzionet e Komisionit, lidhur me depozitën dhe llogarinë në” Credins Bank”.

Komisioni, konstaton se përputhen vlerat e deklaruara të depozitës dhe llogarisë rrjedhëse në momentin e deklarimit (datë 27.01.2017), me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.

Nisur nga fakti që të ardhurat e dokumentuara të përfituara nga emigracioni në Greqi nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të mëparshme analizuar sa më lart, Komisioni, vlerëson se subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e depozitës në “Credins Bank”, në emër të personit të lidhur.

Depozitat dhe llogaritë rrjedhëse pranë Bankës Kombëtare Tregtare.

24.16 Depozitë pranë “BKT”-së¹⁸.

- i. Vlera e deklaruar: 300,000 lekë;
- ii. Pjesa në përqindje: 100 % në emër të bashkëshortit të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga kursimet nga puna.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “BKT”

24.17 Depozitë pranë “BKT”-së¹⁹.

- i. Vlera e deklaruar: 1,800,000 lekë;

¹⁷ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) konfirmim nga “Credins Bank” me nr. *** prot., datë 23.01.2017.

¹⁸ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): - Kontratë depozite bankare e datës 13.06.2016, e lidhur me “BKT”-në.

¹⁹ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): - Kontratë depozite bankare e datës 18.01.2016, e lidhur me “BKT”-në.

- ii. Pjesa në përqindje: 100 % në emër të bashkëshortit të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga kursimet nga puna në emigracion.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor, lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për depozitën në BKT, në shumën prej 1,800,000 lekë.

24.18 Llogari rrjedhëse në “BKT”-së²⁰.

- i. Vlera e deklaruar: 249,800 lekë;
- ii. Pjesa në përqindje: 100 % në emër të bashkëshortit të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga puna në emigracion.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “BKT”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

“BKT”-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 02.10.2018, na konfirmon se, shtetasi Gj.S ka pranë “BKT”-së llogaritë me të dhënat si më poshtë:

Nr. Llogarisë	Monedha	Statusi i llogarisë	Gjendja aktuale e llogarisë	Shënime të tjera
***	Lekë	Aktive	109,171.49	Kartë debiti
***	Lekë	Aktive	3,468,368.88 (lekë)	Prej të cilave (1) 305,096.17 lekë janë investuar në depozitë me afat 2 vjet, me datë maturimi 15.06.2020; dhe (2) 2,200,000 lekë janë të investuara në depozitë me afat 2 vjet, me datë maturimi 27.2.2023.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ana e kësaj banke, rezulton se në llogarinë nr. ***, janë kryer veprimet si më poshtë:

- i. më datë 15.01.2016, ka depozituar *cash* shumën prej 1,800,000 lekësh;
- ii. më datë 18.01.2016, e ka kaluar shumën prej 1,800,000 lekësh në depozite me afat;
- iii. më datë 25.03.2016, kjo llogari është kredituar nga znj. Y.D në shumën prej 100,000 lekësh, me përshkrimin “pagesë akt ekspertimi për rastin e Kalomi Ahmet” ;
- iv. më datë 13.06.2016, kjo llogari është kredituar me shumën prej 200,000 lekësh;
- v. më datë 14.06.2016, nga bashkimi i shumave prej 100,000 lekësh dhe 200,000 lekësh, ka krijuar depozitën në shumën prej 300,000 lekësh.

Gjendja e llogarisë rrjedhëse me nr. ***, më datë 28.12.2016, është në vlerën prej 249,800 lekësh, ndërsa, më datë 27.01.2017, është në vlerën 249,650 lekë. Kjo llogari është kredituar,

²⁰ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) Vërtetim i lëshuar nga “BKT” me nr. *** prot., datë 23.01.2017; dhe (2) Pasqyra mbi gjendjen e depozitave dhe llogarisë rrjedhëse.

më datë 04.01.2018, me vlerën 200,000 lekë dhe më datë 26.02.2018 me vlerën 150,000 lekë (derdhje *cash* nga z. Gj.S).

Më datë 26.02.2018, shtetësi Gj.S ka transferuar në këtë llogari nga llogaria depozitë shumën prej 1,838,147 lekësh dhe se gjendja e kësaj llogari shkon në vlerën prej 2,285,847.64 lekësh. Nga kjo shumë, po më datë 26.02.2018, ka kaluar në depozitë shumën prej 2,200,000 lekësh. Për sa më sipër, Komisioni, konstaton se përputhen vlerat e deklaruara të depozitave dhe gjendja e llogarisë rrjedhëse në momentin e deklarimit (datë 27.01.2017), me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “BKT”-ja.

Nisur nga fakti që të ardhurat e dokumentuara të përfituara nga emigracioni në Greqi nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të mëparshme analizuar sa më lart, Komisioni, vlerëson se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e e depozitës pranë “BKT” në vlerën prej 1,800,000 lekësh.

24.19 Depozitë pranë “Societe Generale Albania”.²¹

- i. Vlera e deklaruar: 2,511,000 lekë;
- ii. Pjesa në përqindje: 100 % në emër të bashkëshortit të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga kursimet si edhe ekzekutimi i vendimit gjyqësor për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me Institutin e Mjekësisë Ligjore.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Societe Generale Albania”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Referuar të dhënave të dërguara nga “Societe Generale Albania”, me shkresën nr. ***, datë 04.10.2018, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka hapur llogari në këtë bankë, më datë 16.12.2016, me nr. ***.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ana e kësaj banke, rezulton se në llogarinë me nr. ***, janë kryer veprimet si më poshtë:

- i. më datë 28.12.2016, në këtë llogari është transferuar shuma prej 2,500,525 lekësh nga llogaria bankare rrjedhëse e z. Gj.S, në “Raiffeisen Bank”, me nr. ***.

Nga verifikimi i llogarisë rrjedhëse të z. Gj.S, me nr. ***, në “Raiffesisen Bank”, vërejmë se:

²¹ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): -Lëvizjet e llogarisë të “Societe Generale Albania”, datë 13.01.2017.

- i. më datë 10.06.2016, është kredituar me shumën prej 894,109 lekësh, me përshkrimin: *“likuidim pjesor detyrimi vendimi nr. ***, datë.17.09.2015, Gjykata Administrative e Apelit”*
- ii. më datë 18.07.2016, është kredituar me shumën prej 200,000 lekësh, me përshkrimin: *“likuidim pjesor detyrimi vendimi nr. ***, datë 17.09.2015, Gjykata Administrative e Apelit”;*
- iii. më datë 05.12.2016, është kredituar me shumën prej 744,291 lekësh, me përshkrimin: *“likuidim pjesor detyrimi vendimi nr. ***, datë 17.09.2015, Gjykata Administrative e Apelit”;*
- iv. kjo llogari është kredituar në vazhdimësi me të ardhura nga likuidimi i faturave në favor të z. Gj.S, si pagesa për ekspert mjeko-ligjor.
- v. më datë 28.12.2016, shuma prej 2,500,525 lekësh është transferuar në llogarinë në “Societe Generale Albania”.

Për sa më sipër, Komisioni, konstaton se përputhet vlera e deklaruar e kësaj depozite në momentin e deklarimit (datë 27.01.2017), me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Societe Generale Albania”

Depozitat dhe llogaritë rrjedhëse pranë “Raiffeisen Bank”.

24.20 Depozitë pranë “ Raiffeisen Bank”²².

- i. Vlera e deklaruar: 850,000 lekë;
- ii. Pjesa në përqindje: 100 % në emër të bashkëshortit të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga puna në emigracion.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për depozitën pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën prej 850,000 lekësh.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank” dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 18.09.2018, rezulton se kjo depozitë është krijuar, më datë 07.08.2015, dhe më pas më datë 08.08.2016 është ridepozituar me afat 2-vjeçar deri më datë 08.08.2018.

24.21 Depozitë pranë “Raiffeisen Bank”²³.

- i. Vlera e deklaruar: 1,650,000 lekë;
- ii. Pjesa në përqindje: 100 % në emër të bashkëshortit të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga puna në emigracion.

²² Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI): - Nxjerrjen e llogarisë nga Raiffeisen Bank, datë 23.01.2017.

²³ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): - Nxjerrjen e llogarisë nga “Raiffeisen Bank”, datë 23.01.2017.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për depozitën pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën prej 1,650,000 lekësh.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank”, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 18.09.2018, kjo depozitë është krijuar në datë 15.03.2016, me vlerë 1,650,000 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ana e kësaj banke, rezulton se kjo depozitë është krijuar duke derdhur *cash* vlerën 1,550,000 lekë, me përshkrimin: “*sa derdh në llogari të ardhurat nga kursimet*”. Rezulton se, vlera prej 1,650,000 lekë është depozituar me afat 2-vjeçar deri më datë 15.03.2018.

24.22 Llogari rrjedhëse pranë “Raiffeisen Bank”²⁴.

- i. Vlera e deklaruar: 343,649.83 lekë;
- ii. Pjesa në përqindje: 100 % në emër të bashkëshortit të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga puna në emigracion dhe kursime.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka nuk përbën problem për kontrollin, për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe konkretisht, deklarimi i përket datës 23.01.2017, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 27.01.2017.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga “Raiffesisën Bank”, konfirmohet se përputhet gjendja e kësaj llogarie rrjedhëse me deklarin e subjektit, për momentin kur ajo është deklaruar.

Konkluzionet e Komisionit, lidhur me këto pasuri:

Komisioni, konstaton se përputhen vlerat e deklaruara të depozitave dhe e llogarisë rrjedhëse në momentin e deklaramit (datë 27.01.2017), me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

Nisur nga fakti që të ardhurat e dokumentuara të përfituara nga emigracioni në Greqi nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të mëparshme analizuar sa më lart, Komisioni vlerëson se, subjekti ka bërë deklarin të pamjaftueshëm dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e depozitave në “Raiffeisen Bank”.

Depozitat në “Union Bank”, në emër të personit të lidhur

²⁴ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI): - Vërtetim mbi nxjerrjen e llogarisë nga “Raiffeisen Bank”, datë 23.01.2017.

24.23 Depozitë pranë “Union Bank”²⁵.

- i. Vlera e deklaruar: 750,000 lekë;
- ii. Pjesa në përqindje: 100 % në emër të bashkëshortit të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga puna në emigracion.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për depozitën në “Union Bank”, në shumën prej 750,000 lekësh.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Referuar të dhënave të dërguara nga “Union Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2018, konkretisht të dhënat e llogarisë me nr. ***, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka depozituar, më datë 26.01.2017, shumën prej 750.000 lekësh. Në të njëjtën ditë shuma është transferuar në depozitë me afat.

24.24 Depozitë pranë “Union Bank”.²⁶

- i. Vlera e deklaruar: 10,600 euro;
- ii. Pjesa në përqindje: 100% në emër të bashkëshortit të subjektit;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga puna në emigracion.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për depozitën në Union Bank, në shumën prej 10,600 euro.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Referuar të dhënave të dërguara me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2018, nga “Union Bank”, konkretisht llogarisë me nr. *** në euro, rezulton se bashkëshorti i subjektit ka depozituar, më datë 26.01.2017, shumën prej 10,600 eurosh, me burim të deklaruar të ardhura nga emigracioni. Në të njëjtën ditë shuma është transferuar në depozitë me afat.

24.25 Depozitë pranë “Union Bank”²⁷

- i. Vlera e deklaruar: 1,706 USD;
- ii. Pjesa në përqindje: 100 %;
- iii. Burimi i krijimit: të ardhura nga puna në emigracion.

Konkluzioni i ILDKPKI-së: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacion e dorëzuar, si edhe përgjigjet e ardhura nga Union Bank” dhe DPPP-së.

²⁵ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): - Vërtetim nga “Union Bank” nr. ref. ***, datë 26.01.2017.

²⁶ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): - Vërtetim nga “Union Bank” nr. ref. ***, datë 26.01.2017.

²⁷ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): - Vërtetim nga “Union Bank” nr. ref. ***, datë 26.01.2017.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Referuar të dhënave të dërguara me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2018, nga “Union Bank”, konkretisht të llogarisë me nr. *** në USD, rezulton se bashkëshorti i subjektit ka depozituar, më datë 26.01.2017, shumën prej 1,706 USD, dhe në të njëjtën ditë shuma është transferuar në depozitë me afat.

Konkluzionet e Komisionit, lidhur me këto pasuri:

Komisioni, konstaton se përputhen vlerat e deklaruara të depozitave në momentin e deklarimit (datë 27.01.2017), me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Union Bank”. Nisur nga fakti që të ardhurat e dokumentuara të përfituara nga emigracioni në Greqi nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të mëparshme analizuar sa më lart, Komisioni, vlerëson se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e depozitave në “Union Bank”.

Subjekti, në përgjigje e pyetësorëve, prapësimet e sjella mbas dërgimit të rezultateve të hetimit si edhe gjatë seancës dëgjimore, ka pretenduar se të ardhurat e përfituara nga puna në shtetin Grek, janë më të larta se ato të dokumentuara me dokumentacion provues.

Në prapësimet e sjella pranë Komisionit, ndër të tjera subjekti ka deklaruar se një pjesë e depozitave bankare janë hapur në dy vitet e fundit dhe kjo ka të bëjë me faktin se me ndryshimet Kushtetuese u bë subjekt që ishte objekt i rivlerësimit kalimtar dhe ligji nuk i lejonte mbajtjen e vlerave monetare *cash* mbi 1,500,000 lekë. Subjekti ka evidentuar faktin se, përpara këtyre ndryshimeve ajo dhe bashkëshorti i saj nuk kishin asnjë detyrim ligjor që të përcaktonte ndalime lidhur me mënyrën se si do i ruanin dhe dispononin të ardhurat e tyre. Në vijim ka deklaruar se një pjesë e këtyre depozitave janë hapur vite më parë, duke filluar në vitin 2006, në vijim në vitin 2011, 2012, etj.

Komisioni, vëren se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të justifikojë me dokumentacionin e duhur ligjor transferimin e këtyre shumave të pretenduara si të përfituara nga emigracioni, nga shteti Grek drejt shtetit Shqiptar. Komisioni vlerëson se, nuk duken bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë seancës dëgjimore, lidhur me mënyrën e transferimit të këtyre shumave drejt shtetit Shqiptar.

Gjithashtu, e pyetur në seancën dëgjimore se pse ka mbajtur shuma të konsiderueshme në *cash*, dhe nuk i ka depozituar më parë në bankë (para lindjes së detyrimit ligjor), subjekti i rivlerësimit deklaroi se këto shuma janë mbajtur *cash* pasi nuk kishte besim tek sistemi bankar, fakt i cili nuk e bind Komisionin, pasi sikurse është vetëdeklaruar po ashtu edhe nga evidentimi i bërë nga ana jonë, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë krijuar depozita edhe para ndryshimeve Kushtetuese dhe lindjes së detyrimit për deklaram pranë ILDKPKI-së.

Për sa më sipër, Komisioni, vëren se subjekti ka kryer deklaram kontradiktor lidhur me faktin se pse ka mbajtur shuma të konsiderueshme *cash* për një periudhë të gjatë kohe, çka na krijon bindjen se këto të ardhura nuk janë të ardhura të krijuara nga puna në emigracion.

Si përfundim Komisioni çmon se, subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor, qoftë dhe me indice indirekte, se të ardhurat e përfitur nga emigracioni janë më të larta nga ato të evidentuara me dokumentacion justifikues ligjor.

Analiza financiare për periudhën 01.01.2009 - 27.01.2017²⁸

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti, Komisioni analizoi treguesit financiarë për këtë periudhë.

- Të dhënat lidhur me pasuritë, të ardhurat, shpenzimet dhe detyrimet, për periudhën prej datës 01.01.2009 – 27.01.2017 (data e dorëzimit të deklaratës “Vetting”), reflektohen në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi	Shuma në Lekë
Të ardhurat neto nga pagat e subjektit, 01.01.2009 - 18.01.2017	6,099,370
Të ardhura të bashkëshortit të subjektit, periudha 2009 - 2016 pagë + dëmshpërblim+ fitim neto nga aktiviteti tregtar deri më datë 23.01.2017	10,155,617
Të ardhura të tjera (interesa bankar etj..)	473,107
Total të ardhura	16,728,094
Shpenzime arsimimi 2013 - 2016 ²⁹	661,200
Shpenzime shëndetësore deklaruar në 2011 ³⁰	623,883
Shpenzime për pushime dhe udhëtime 2013 - 2016 ³¹	540,992
Shpenzime të tjera	58,483
Shpenzime jetese për periudhën 2009 - janar 2017	5,935,268
Total shpenzime	7,819,826
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> gjendje fillim - gjendje fund periudhe (0-1.400.000 lek)	-1,400,000
Ndryshim mjete monetare në bankë, gjendje fillim - gjendje fund periudhe (1,598,429 lekë – 19,535,425 lekë)	-17,936,996
Mjete monetare të disponueshme (1)	-10,428,728
Pagesa për shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k., vlera prej 1 300 euro	175,799
Pagesa për blerje pasurie, automjetit “Smart”, vlera prej 2 700 euro	378,378
Total pasuri	554,177
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	554,177
Balanca e fondeve (1-2)	-10,982,905

Nga sa më sipër Komisioni konstaton se, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara (likuiditeteve gjendje në llogari bankare dhe ato gjendje *cash*) përgjatë periudhës 01.01.2009 – 27.01.2017, nga ku

²⁸ periudha në të cilën janë shtuar pasuritë në likuiditete në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj

²⁹ vetëdeklaruar nga ana e subjektit në pyetësor

³⁰ vetëdeklaruar nga ana e subjektit

³¹ sipas përlogaritjes dhe konfirmimit të subjektit në prapësimet e sjella

vërehet se disa pasuri janë evidentuar për herë të parë duke u depozituar në llogari bankare, gjatë kohës që subjekti ka qenë në funksionin e ndihmësës ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

25. Pasuri të paluajtshme të krijuara nga personi i lidhur (Gj.S), pas dorëzimit të deklaratës “Vetting”.

ZVRPP-ja Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2018, ndër të tjera na konfirmon se, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit rezultojnë të regjistruara edhe pasuritë:

- i. Apartament, me sipërfaqe 12 m², ndodhur në ZK nr. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***;
- ii. Apartament, me sipërfaqe 12 m², ndodhur në ZK nr. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se, nga ana e ZVRPP-së Vlorë na është dërguar vetëm kartela e pasurisë që i përket apartamentit me sipërfaqe 12 m², ndodhur në ZK nr. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, regjistruar pranë ZVRPP-së Vlorë, më datë 25.04.2017, në emër të shtetasit Gj.S. Ndërsa, nga verifikimi i pasqyrës llogaritëse të tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë, rezulton se shtetasi Gj.S e ka blerë këtë pasuri për vlerën prej 600,000 lekësh, dhe se palë shitëse është shtetasi H.M.

Noteri A.Xh, me shkresën e datës 05.11.2018, protokolluar me tonën me nr. ***prot., datë 08.11.2018, na ka dërguar kontratën e shitjes me nr. ***, datë 21.03.2017, sipas të cilës shtetasi V.M dhe H.M i kanë shitur shtetasit Gj.S, pasurinë e llojit apartament, me sipërfaqe 12 m², me nr. ***, vol. ***, fq. ***, për vlerën prej 600,000 lekësh.

“BKT” me shkresën nr. *** prot., datë 02.10.2018, na informon se subjekti i rivlerësimit znj. Ana Gollosi, më datë 21.03.2017, ka derdhur shumë prej 600,000 lekësh në llogari të z. A.Xh, person fizik, me përshkrimin: *“Tjetërsim pasurie Gj.S pagesë për blerjeje apartamenti sipas kontratës nr. ***, datë 21.03.2017.”*

Subjektit iu kërkua të na konfirmojë nëse kemi të bëjmë me të njëjtën pasuri apo dy pasuri të ndryshme, të na vejë në dispozicion dokumentacionin justifikues lidhur me këtë pasuri, si edhe të na deklarojë burimin e krijimit të saj.

Me prapësimet e sjella subjekti na konfirmoi se kemi të bëjmë vetëm më një pasuri, duke depozituar pranë këtij Komisioni dokumentacionin provues lidhur me të, si edhe deklaroi se burimi i krijimit të kësaj pasurie është një pjesë e të ardhurave *cash* të deklaruara në deklaratën “Vetting”.

Komisioni vëren se, të ardhurat e deklaruara *cash* nga subjekti i rivlerësimit që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie janë përfshirë në analizat financiare të mëparshme. Subjekti paraqiti dokumentacionin ligjor lidhur me këtë pasuri, i cili përputhet me dokumentacionin e administruar nga ana jonë në kuadër të hetimit administrativ.

26. Depozitë e krijuar rishtazi nga bashkëshorti i subjektit, pas dorëzimit të deklaratës “Vetting”.

Referuar të dhënave nga “ABI Bank”, shtetasi Gj.S ka depozituar *cash*, (1) më datë 04.04.2018, shumën 600.000 lekë, (2) më datë 24.05.2018, shumën prej 300.000 lekësh; (3) më datë 12.09.2018 është transferuar shuma hyrëse prej 1,600, 000 lekësh; dhe (4) më datë 14.09.2018, ka kaluar në depozite me afat shuma 2,500,000 lekë

Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të deklarojë burimin e krijimit të kësaj pasurie të shoqëruar me dokumentacionin justifikues ligjor.

Lidhur me këtë pasuri, subjekti deklaroi se ka si burim të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit të saj si vlerësues dëmsh në sigurime dhe ekspert mjeko-ligjor, duke depozituar si provë formularin e deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2008 si edhe pagesën e tatimit në “Raiffeisen Bank”.

Komisioni vëren se, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti rezultoi se tatimpagusi “****” me NIPT ***, ka realizuar fitime të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e kësaj depozitë në “Abi Bank”.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE FINANCIARE

27. Pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti, Komisioni analizoi treguesit financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet, për periudhën prej vitit 1996 - 27.01.2017, të cilat reflektohen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi	Shuma në Lekë
1	Të ardhura të dokumentuara 1996 - 27.01.2017	32,994,015
2	Shpenzime jetese, arredimi , shëndetësore, arsimit, etj., për periudhën 1996 - 01/2017	18,813,704
	Të ardhura Neto (1-2)	14,180,311
3	Pasuri të blera dhe të krijuara	32,950,240
4	Detyrime, më datë 27.01.2017	0
	Pasuri Neto (3-4)	32,950,240
	Raporti pasuri neto/të ardhura neto	2,32

28. Komisioni vëren se, subjekti i rivlerësimit në prapësimet e sjella pranë këtij Komisioni ka paraqitur një akt ekspertimi financiar të përpiluar nga eksperti kontabël G.B, ku paraqitet analiza financiare përmbledhëse e të ardhurave, shpenzimeve dhe pasurive të paluajtshme për vitet 1996 - 2017.

28.1 Me anë të këtij akt ekspertimi, subjekti ka pretenduar të hedhë poshtë rezultatet e analizës financiare të përpiluar nga Komisioni dhe të dërguara me rezultatet e hetimit administrativ, duke nxjerrë përfundimin se raporti i pasurisë neto me të ardhurat neto është në vlerën 1.78, duke evidentuar në fakt se nuk justifikon plotësisht me burime të ligjshme krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve përgjatë kësaj periudhe, por duke pretenduar se ajo dhe personat e lidhur me to nuk kanë deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme.

28.2 Gjithsesi, sikurse e kemi evidentuar edhe më sipër, Komisioni, vlerësoi me objektivitet të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe reflektoi ndryshimet përkatëse, në analizën financiare përfundimtare për periudhën objekt hetimi.

Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë

29. Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit si dhe dëgjoji atë në seancë dëgjimore, në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme duke përfshirë dhe personat e lidhur;
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe jo në përputhje me ligjin;
- iii. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive në emrin e saj dhe personit të lidhur me të.

B. KONTROLLI I FIGURËS

30. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

31. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar pjesërisht me Vendim të K.D.ZH-së me nr. ***, datë 18.12.2018. Sipas këtij raporti, subjekti ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Grupi i Punës ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Ana *** Gollosi.

32. Gjithashtu, me anë të këtij Raporti Grupi i Punës pranë DSIK-së na informon se: “Për shtetasin Gj.S (bashkëshortin e subjektit) hidhen dyshime se është përfshirë në veprime korruptive dhe se janë dërguar materialet procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për regjistrimin e procedimit penal në ngarkim të këtij shtetasi për veprën penale të “Korrupsionit pasiv nga persona që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

33. Nga verifikimet e bëra në sistemin *TIMS* në lidhje me shtetasin Gj.S, rezultoi se, më datë 14.07.2014, ndaj tij ka filluar procedim penal në gjendje të lirë për veprën penale të “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Në këtë kohë, bashkëshorti i subjektit, ka qenë pedagog në “Fakultetin e Infermierisë”.

34. Me shkresën nr. ***, datë 17.09.2018, iu kërkua informacion Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2018, na vuri në dispozicion kopje të fashikullit të procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, që i përket dosjes objekt hetimi.

34.1 Nga verifikimi i kësaj dosjeje hetimore rezulton se:

- i. më datë 08.07.2014, është bërë regjistrimi i kallëzimit penal nr. *** mbi bazën e procesverbalit *“Mbi marrjen e kallëzimit”* të shtetasit P.D.;
- ii. më datë 22.07.2014, bazuar në urdhrin e prokurorit *“Mbi regjistrimin e procedimit penal”*, është regjistruar procedimi penal me nr. ***, për veprën penale të *“Shpërdorimit të Detyrës”*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal;
- iii. më datë 05.10.2016, është nxjerrë vendimi *“Për zëvendësimin e prokurorit”*;
- iv. më datë 12.12.2016, është dhënë *Vendimi “Për pushimin e Çështjes”*.

34.2 Nga verifikimi i materialeve të kësaj dosje nuk provohet që bashkëshorti i subjektit të ketë pasur dijeni që ndaj tij është regjistruar procedim penal, pasi nuk rezulton që ai të jetë thërritur dhe të jetë pyetur nga organi procedues. Nuk kemi të dhëna që bashkëshortit të subjektit, ti jetë regjistruar emri në regjistrin e emrave të personave të cilëve iu atribuohet vepra penale. Në vendimin e pushimit është shënuar se, *“me këtë vendim të njoh palët e interesuara, të cilat pas marrjes dijeni kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”*, por nuk rezulton që ky vendim ti jetë dërguar për njohje bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

35. Po ashtu, nga sistemi *TIMS* rezulton se, më datë 18.10.2017, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit janë referuar materialet e para hetimore në ngarkim të bashkëshortit të subjektit, për konsumimin e veprës penale të *“Shpërdorim detyre”* dhe *“Ekspertim të rremë”*, parashikuar nga nenet 248 dhe 309, të Kodit Penal. Në këtë kohë bashkëshorti i subjektit ka qenë ekspert privat për caktimin e dëmeve shëndetësore.

35.1 Me shkresën nr. *** prot., datë 25.09.2018, iu kërkua informacion Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 03.10.2018, na vuri në dispozicion kopje të vendimit për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2017, që lidhet me dosjen objekt hetimi.

35.2 Nga verifikimi i materialeve të kësaj dosjeje rezulton se, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, e vitit 2017, në të cilin dega e shoqërisë së huaj *“****”* ka kallëzuar bashkëshortin e subjektit, në cilësinë e ekspertit mjekësor/vlerësues dëmsh, për veprat penale të parashikuara nga nenet 248 dhe 309 të Kodit Penal.

Konkluzione për vlerësimin e kontrollit të figurës

36. Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

37. Trupi gjykues vlerëson se, subjekti i rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

38. Në mbështetje të pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndihmësat ligjorë pranë Gjykatave Administrative vlerësohen bazuar në:

- a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe
- b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

39. Lidhur me kriterin e parë vlerësues, është përgatitur një raport i hollësishëm nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

39.1 Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; dhe (2) pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

40. Në analizë të Raportit të Vlerësimit të kryer nga KLD-ja, Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficientë dhe efektive në masë të pranueshme.

❖ Rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës

41. Shkolla e Magjistraturës me shkresën, nr. *** prot., datë 23.05.2018, ka dërguar rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuar në pikën 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe sipas parashikimeve të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

41.1 Rezulton se, me vendimin e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, nr. ***, datë 21.05.2018, janë miratuar rezultatet e të dy fazave të testimit, për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, zhvilluar nga kjo shkollë në datat 7 - 8 maj 2018.

41.2 Nga verifikimi i tabelave të rezultateve konstatohet se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale, subjekti ka marrë 62 pikë nga 100 pikë të mundshme, ndërsa në fazën e dytë ka marrë 151 pikë nga 200 të mundshme.

42. Me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2018, Shkolla e Magjistraturës na konfirmon se, në mbështetje të nenit 165, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Ana Gollosi, bën pjesë në subjektet të cilët kanë marrë të paktën 60 % të pikëve në testimin e aftësive profesionale dhe se ka të drejtë të ndjekë programin dy-vjeçar të trajnimit teorik dhe të praktikës profesionale në Shkollën e Magjistraturës.

43. Ndërsa, me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2018, Shkolla e Magjistraturës na informon se, bazuar në pikën 4 të nenit 16 të ligjit nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar deklaratën duke shprehur vullnetin për të ndjekur Programin e Trajnimit 2-vjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës dhe ka nënshkruar marrëveshjen e regjistrimit me këtë shkollë.

44. Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues pas propozimit të relatorit të çështjes arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin minimal kualifikues, në kuptim të nenit 59, germa c), të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme duke përfshirë dhe personat e lidhur;
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 , pasi (a) ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin; dhe (b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive në emrin e saj dhe personit të lidhur me të.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe të nenit 61, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 13.02.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Firdes SHULI
Anëtare

Pamela QIRKO
Relatore

Gledis Hajdini
Sekretare gjyqësore